



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2023:132752  
Datë: 29.06.2024  
Numri i dokumentit: 05876549

CAP.nr.962/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridike - përmbartimore të kreditorit H.SH. nga fshati .... Komuna e Gjilanit, kundër debitores Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me çështjen përmbartimore, për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitores, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Novobërdë, CPK.nr.05/2023, datë 21.06.2023, me datë 24.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitores Komuna e Novobërdës - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Novobërdë, CPK.nr.05/2023, i datës 21.06.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar CPK.nr.05/2023 të datës 21.06.2023, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të Refuzohet si i pa bazuar prapësimi i datës 15.05.2023, i debitorit Komuna e Novobërdës - DKA, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.265/23 të datës 28.04.2023, të Përmbartuesit Privat B.M. nga Peja. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të Mbetet në Fuqi Urdhëri Përmbartimor, P.nr.265/23 i datës 28.04.2023. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të Obligohet debitori Komuna e Novobërdës - DKA, qe kreditorit t'ia, paguaj shumë në lartësi prej 117 €, në emër të shpenzimeve të procedurës përmbartimore për ushtrimin e përgjegjës në kundërshtim.

Kundër këtij aktvendimi debitorja brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke mos specifikuar shkaqet e ankesës, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, të pezullohet përmbartimi i përcaktuar me urdhrin ekzekutiv dhe të anulohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë me të

cilin është refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe të anulohen të gjitha veprimet e ekzekutuara.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se

Ankesa e debitores është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim, në vlerë borxhit prej 259€, në bazë të pikës II të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.567/20 datë 23.03.2021, i plotfuqishëm me datën 14.02.2022 dhe i ekzekutueshëm me datën 30.03.2023, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në shumë 117€.

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të datës 28.04.2023, ka nxjerr urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.265/23 i datës 28.04.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, duke vlerësuar se aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.567/20 i datës 23.03.2021, i plotfuqishëm me datën 14.02.2022 dhe i ekzekutueshëm me datën 30.03.2023, i plotëson kushtet si vendim përmbartues i dhënë në procedurë gjyqësore.

Kundër Urdhrit mbi Lejimin e Përmbartimit debitorja ka paraqitur prapësim me datën 10.05.2023, me propozim që të pranohet si i bazuar kundërshtimi i debitores, e të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra nga përmbartuesi privat.

Me përgjigje në prapësim të datës 30.05.2023, kreditori ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar në ligj prapësimi i debitorit kundër propozimit për përmbartim të dhënë nga Përmbartuesi privat dhe detyrohet debitorja në pagesën e përgjigjes në prapësim sipas tarifës së OAK-së në shumën prej 117 €.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e atakuar CPK.nr.05/2023, të datës 21.06.2023, ka vendosur që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.265/23 datë 28.04.2023, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se prapësimi i debitorit i datës 15.05.2023 është i pabazuar, sepse nuk përmban asnjërin nga shkaqet e prapësimin sipas nenit 71 të LPP-së, pasi që Aktgjykimit i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.567/20 të datës 23.03.2021, i bërë i plotfuqishëm me datën 14.12.2022 dhe i ekzekutueshëm me datën 30.03.2023, në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi, është dokument përmbartimor - titull ekzekutiv, ose ka tipare të përmbartueshmërisë, konform nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të LPP-së, në rastin konkret aktvendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është pjesë e aktgjykimit të lartshënuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 22, 71, 72 dhe 73 të LPP-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së.

Është vlerësim i Gjykatës së Apelit se gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar si të pabazuar, duke dhënë arsye përkatëse në

pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar, se në prapësimin e debitorit nuk janë paraqitur asnjë nga shkaqet të cilat janë parapara në nenin 71 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), që do të pengonin përmbartimin e lejuar.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejt faktin se aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.567/20 i datës 23.03.2021, i plotfuqishëm me datën 14.02.2022 dhe i ekzekutueshëm me datën 30.03.2023, në këtë rast është dokument përmbartues, kjo përcaktohet me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, se: “Dokument përmbartimore është vendimi përmbartues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbartuese”, dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i këtij ligji, ku përcaktohet se “dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit” ndërsa me nenin 24 paragraf 1 të LPP-së, përcaktohet se “Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbartja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbartueshëm po që se ka marr formën e prerë si dhe po që se ka skaduar afati për përmbartje vullnetare”.

Në procedurën përmbartimore behet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se “Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Në këtë rast debitori me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në nenin 3 paragraf 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr. 962/23, me datë 24.06.2024

Gjyqtarja  
Hunaida Pasuli